

AMBASADA E PARË E FËMIJËVE NË BOTË - MEGJASHI 1992-2007



INFORMATË

15 vjet të ekzistimit dhe veprimit të Ambasadës së Parë të Fëmijëve në Botë – Megjashi, Republika e Maqedonisë

Ambasada e Parë e Fëmijëve në Botë u themelua më 29 prill të vitit 1992 në Shkup, si asociacion botëror dhe organizatë e parë e regjistruar ndërkombëtare, jofitimprurëse, jopartiake dhe joqeveritare në Republikën e Maqedonisë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Ambasada Megjashi angazhohet për respektimin e personalitetit të fëmijëve nëpërmjet mbrojtjes së të drejtave të tyre, përfaqësimit të interesave të fëmijëve dhe nëpërmjet pasurimit të jetës së tyre me përmbajtje, të cilat fëmijërinë e bëjnë të sigurt dhe kreative. E përforcon lëvizjen OJQ për të drejtat e fëmijëve duke zhvilluar qasje vullnetare në punë dhe përkujdeset për realizimin e Konventës së të drejtave të fëmijëve.

Ambasada me aktivitetet e veta kontribuoi në zhvillimin dhe përforsimin e vetëdijes qytetare për të drejtat e fëmijëve. Ajo theu heshtjen për vuajtjet fëmijërore, sidomos për keqpërdorimin fizik, seksual dhe ekonomik të fëmijëve, duke zbuluar në opinionin publik më shumë raste të keqpërdorimit dhe drejtpërdrejt duke u angazhuar për implementimin e mekanizmave më efikas për mbrojtjen e fëmijëve.

Rezultate më të rëndësishme të 15 viteve të kaluara:

- **Viti 1992-1997.** Me të filluar kriza në Bosnje e Hercegovinë, Ambasada e Parë e Fëmijëve bën apel për mbështetje dhe organizon pranimin e fëmijëve ikanakë, destinacione drejt vendeve të huaja, ndihmë humanitare dhe aktivitet kreativ me çka u ndihmon gjashtëdhjetëmijë fëmijëve ikanakë;
- **Viti 1993-2007.** Ambasada hap telefonin e parë kujdestar SOS për fëmijë dhe të rinj dhe këshillimore psikologjike në Republikën e Maqedonisë. Në vitin 2005, nga Telekomunikacionet e Maqedonisë fiton numrin 08001222, me çka u mundëson fëmijëve që thirrjet e tyre të jenë falas. **Për 14 vjet – mbi 17 000 thirrje;**

- Në **vitin 1993** boton librin “Të drejtat e fëmijës”, i pari i këtij lloji në Republikën e Maqedonisë;
- **Viti 1993-2006.** Punëtori të fëmijëve, shfrytëzim kreativ të kohës së lirë – të përfshirë mbi 8 000 fëmijë;
- **Vitit 1994.** Fillon të llojë për inkorporimin e institucionit Ombudsman i fëmijëve. Në vitin 1999 Republika e Maqedonisë implementoi Avokatin e popullit, person kompetent për të drejtat e fëmijëve;
- **Vitit 1997.** Ambasada Megjashi, si anëtare shoqëruese, i bashkëngjitet Defence for Children International dhe formon Komitet DCI në Maqedoni. Në vitin 1999, ky Komitet regjistrohet si OJQ e veçantë për të drejtat e fëmijëve – Shoqatë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve;
- **Viti 1997-2002.** Ambasada formon Koalicionin Kombëtar të Maqedonisë për të drejtat e fëmijëve (28 OJQ), me Sekretariat në Ambasadën Megjashi. Ky koalicion dërgon edhe raport alternativ për gjendjen e të drejtave të fëmijëve në Komitetin për të drejtat e fëmijëve në Gjenevë;
- **Viti 1999.** Si koordinator kombëtare i bashkëngjitet familjes Global March Against Child Labour, duke realizuar aksion për ngritjen e vetëdijes publike kundër eksploatimit të punës së fëmijëve dhe duke përfshirë të gjithë fëmijët në arsimim.
- Vitit 1999-2000. Ambasada Megjashi u jep mbështetje fëmijëve refugjatë nga Kosova, duke u ofruar mbrojtje në planin psikosocial; Përfshihen të gjitha kampet në Maqedoni ku përkujdesen fëmijët ikanakë nga Kosova.
- **Vitit 2000-2001.** Fushatë për ratifikimin e Konventës 182 dhe të Rekomandimit 190 për eliminim urgjent të formave më të këqija të punës fëmijërore. Në vitin 2002, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë i ratifikoi të njëjtat;
- **Viti 2001-2006.** Hapet punkt pranimi për fëmijë në gjendje krize, ku përkujdesen 16 fëmijë të shpërngulur nga fshati Haraçinë, prej të cilëve 8 fëmijë. Tre prej tyre linden në punkt. Ata janë akoma në punktin tonë .
- **Viti 2001.** Ambasada Megjashi fiton çmimin për shoqëri qytetare dhe demokraci, si rezultat i kontributit shumëvjeçar dhënë për ndërtimin e shoqërisë qytetare në Republikën e Maqedonisë. Çmimi i ndahet nga ana e QMBN;
- **Viti 2001-2004.** Ambasada formon Lidhjen e organizatave të fëmijëve në Republikën e Maqedonisë dhe përpilon e boton KODEKS-in e parë të OJQ-ve për të drejtat e fëmijëve tek ne. I njëjti përkthehet edhe në gjuhën shqipe dhe vendoset në sajtin www.childrenembassy.org.mk;
- **Viti 2001-2002.** Ambasada ngrit iniciativë për ndryshimin e ligjeve tatimore që kanë të bëjnë me organizatat jofitimprurëse, e quajtur në mënyrë popullore 1%.
- **Viti 2002-2004.** Për avancimin e punës vullnetare në Republikën e Maqedonisë, Ambasada Megjashi punon përmes Programit **Aksioni vullnetar i Maqedonisë** (AVM);
- **Viti 2002-2006.** Fillon programi për përpunimin jo të dhunshëm të konflikteve në shkollat e mesme multietnike në Republikën e Maqedonisë;
- Viti 2003. Ambasada, në bashkëpunim me Centro Regionale di Intervento per la Cooperazione (CRIC) e Italisë, realizon projektin “Aksion për qytetari nëpërmjet teatrit” ku përfshihen 60 fëmijë të 3 shkollave multietnike si dhe prindërit e tyre;

- **Viti 2003.** Ambasada fillon të krijojë **Punëtori për të drejtat e fëmijëve në shkollat fillore multietnike** për përmirësimin e mirëkuptimit ndërmjet fëmijëve që rrjedhin nga mjedise të ndryshme etnike. Përfshimë 15 grupe fëmijësh në 15 shkolla fillore multietnike, në Shkup dhe rrethinë. Koordinator i këtij projekti qe Rexhep Raimi
- **Viti 2004.** Në bashkëpunim me H.A ECE në periudhë prej qershorit deri në shtator, përgatit 53 propozim-amendamente për ndryshim dhe plotësim të ligjit për familjet dhe vërejtje për propozim-ligjin për mbrojtje sociale dhe fëmijërore;
- **Viti 2004.** Ambasada Megjashi së bashku me disa anëtare të tjera të Platformës qytetare të Maqedonisë vendosin vullnetarisht t'i shpallin raportet vjetore, përfshirë edhe raportet financiare dhe mendimet e pavarura revizore.
- **Viti 2004.** Ambasada boton librin “Mbrojtja e të drejtave të fëmijës” si pasqyrë e gjendjes së fëmijëve në Republikën e Maqedonisë, ku autorja Milica Paneva propozon sugjestione dhe rekomandime të caktuara përfundimtare për gjendjen e fëmijëve në Republikën e Maqedonisë.
- **Viti 2005.** Realizohet fushata botërore për përfshirjen e fëmijëve në shkollë “Global Campaign for Education”, me moton “T’i kyçim fëmijët në shkolla – Ç’mund të bëj unë?”
- **Viti 2005.** Realizuar aktivitetet për zvogëlimin e konflikteve ndërmjet nxënësve të shkollave të mesme përmes trajnimit të arsimtarëve dhe nxënësve për përpunim jo të dhunshëm të konflikteve. Shoqërimi nëpërmjet bashkëpunimit multietnik u realizua në 5 shkolla të mesme multietnike në Shkup, Kumanovë dhe Tetovë.
- **Viti 2005.** Më datë 09.11.2005 – ditën ndërkombëtare kundër fashizmit dhe antisemitizmit, organizuar aksion për fshirjen e grafitëve “Ta flakim dhunën nga muret”. Grafitet “**Stop dhunës**”, “**Duaj që të të duan**”, “**Paqe**” i zëvendësuan porositë e dhunshme të shkruara nëpër mure. Qëllimi i këtij aksioni ishte që në publik të promovohen vlera të paqes së përhershme, solidaritetit, jodhunës dhe respektimit të të drejtave të të gjithë njerëzve që jetojnë në Republikën e Maqedonisë.
- **Viti 2006.** Ambasada pajis në mënyrë complete një banesë me mobile dhe orendi të tjera shtëpiake, e që është vendbanim i ardhshëm i katër të rejave: Fatima Ajdar, Aleksandra Spasovska, Sanja Spasovska dhe Nadira Bajramovska deri në moshën e tyre 26-vjeçare. Banesën e ndau Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, ndërkaq pajisjen e saj e financoi Ministria e Financave-Banka Botërore nga Projekti për zhvillimin e komunave (PZHK). Të rejat zyrtarisht u vendosën në banesë më datë 15.02.2006.
- **Viti 2007.** Ambasada fillon vitin me fushatën “**Stop dhunës ndaj fëmijëve**” dhe “**A e përqaftat sot fëmijën tuaj**”. Ky ishte një reaksion ndaj rrahjeve të fundit deri në vdekje të një fëmije 3-vjeçar dhe të një foshnje gjashtëmujore, kurse si rezultat i numrave në rritje e sipër të denoncimit të dhunës në 20% të numrit të përgjithshëm të paraqitjeve të rasteve në telefonin tonë SOS për fëmijë dhe të rinj 0800 1222, i cili është falas për të gjithë fëmijët në Maqedoni.
- **Viti 2007.** **Aksion për përfshirjen e të gjithë fëmijëve në arsimim** me moton **Bashkëngjituni! E drejta për arsimim tani!!!** Në aktivitete përshihen mbi 50 shkolla, komuna. Pranim i delegacionit të fëmijëve anëtarë të Ambasadës tek kryetari i Republikës së Maqedonisë, z. Branko Cërvenkovski dhe te nënkryetari i

Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, z. Ivan Anastasiovski. Në ditën e manifestimit qendror që u mbajt në sheshin Maqedonia, aksionin e mbështeti edhe kryetari i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, z. Nikolla Gruevski. Ambasada Megjashi mori edhe garanci me shkrim nga z. Branko Cërvenkovski, z. Nikolla Gruevski, z. Ivan Anastasovski dhe z. Pero Stojanovski, këshilltar shtetëror në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës në Republikën e Maqedonisë, se do të angazhohen për ta realizuar të drejtën që secili fëmijë të shkojë në shkollë.

Ambasada e Parë e Fëmijëve në Botë është anëtare e shumë organizatave dhe trupave vendorë dhe të huaj, ndër të cilët: Platforma qytetare e Maqedonisë, Shtëpia për të drejtat e njeriut në Maqedoni, Koalicioni për gjykim të drejtë, Global March Against Child Labour, Defence for Children International, Child Right's Information Network, Child Helpline International, Europen Foundation for street children worldwide, EUROCHILD, UNITEK, dhe shumë të tjera.

Ambasada e Parë në Botë ka korin e vet diplomatik në pesë kontinente të botës me deri tani mbi 120 diplomatë shfrytëzues të pasaportës sonë diplomatike dhe ka konsullate të veta në Republikën Demokratike të Kongos, Francë, Spanjë, Brazil dhe Itali.

Fëmijë ambasadorë dhe konsuj të deritanishëm të Ambasadës së Parë të Fëmijëve në Botë – Megjashi janë: **Kalina Mërmevska, Mirjana Boshevska, Gjakush Kabashi dhe Stefan Pleskoniq.**

Kjo organizatë ndërkombëtare, e cila është Ambasada e shtetit të parë të fëmijëve në botë – Megjashi, vepron nëpërmjet ambasadorëve të vet, Konsullit të Përgjithshëm dhe Konsullit, përfaqësuesve të përhershëm dhe anëtarëve të nderit të Kolegjiumit, Korit diplomatik të fëmijëve, Konsullatave të përgjithshme, Konsullatave, Njërive konsullore dhe Zyrës në vendin tonë dhe jashtë, si dhe nëpërmjet anëtarëve në Maqedoni dhe në botë.

Ambasador i Ambasadës së Parë të Fëmijëve në Botë – Megjashi, është z. Kole Angellovski.

Fëmijë ambasador është Stefan Pleskoniq.

Themelues të Ambasadës së Parë të Fëmijëve në Botë – Megjashi, Republika e Maqedonisë, janë **Gordana Pirkovska Zmijanac dhe Dragi Zmijanac.**

Drejtor ekzekutiv: mr. Dragi Zmijanac.

Anëtarë të Kolegjiumit: Kole Angellovski, Marija Donevskam, Dragi Zmijanac, Ana Bitunjanu, Rexhep Raimi, Metodija Najçeski, Lidija Balltovska, Roza Vasileva, Bllagoja Çoreski, Milica Paneva, Zumreta Jakupi, Gordana Pirkovska Zmijanac.

Për më tepër informata ju lutem na kontaktoni në këta numra telefoni:

+ 389 (02) 2465 316; + 389 (02) 2463 900 apo

e-mail: first@childrensembassy.org.mk

web-site: www.childrensembassy.org.mk

Citat nga Karta e Ambasadës së Parë të Fëmijëve në Botë – Megjashi

“Fëmijët janë një popull i veçantë. Fëmijët nuk janë prijës ushtarakë kombëtarë apo fetarë. Ata janë një popull i cili asnjëherë nuk ka kryer revolucion apo kundërrevolucion, apo ka nisur ndonjë luftë. Fëmijët nuk janë as çështje klasore apo kombëtare: fëmijët janë çështje mbi të gjitha çështjet. Ata janë një popull i cili më së shumti vuan në përplasjet luftarake dhe tragjeditë njerëzore. FËMIJËT JANË VETËM FËMIJË. TË GJITHA IDEALET NË BOTË JANË MË TË PARËNDËSISHME SE SA LOTËT E NJË FËMIJE”.

Ideja, emri (Ambasada e Parë e Fëmijëve në Botë – Megjashi) dhe maskota (Flokëshprishuri) janë të mbrojtura në Ministrinë e Zhvillimit të Republikës së Maqedonisë, Enti për mbrojtjen e pronës industriale me vulë postare nr. 863, 864 dhe 865 në vitin 1994.

Ambasada e parë e fëmijëve në botë është reregjistruar në Regjistrin e shoqatave të qytetarëve dhe fondacioneve në Gjykatën Themelore – Shkup I, me numrin e regjistrimit 297, me aktvendim nr. 162/98 të datës 15.06.1999. Numri i amzës 4377249. Numri i vetëm tatimor 4030995179890.

